



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 13/2.....Prot.

Tiranë, më 06.01...2026

V E N D I M

Nr. 4 Datë 06.01 2026

PËR

**HAPJEN E KONKURSIT PËR PRANIMIN E 2 (DY) PUNONJËSI, PERSONEL
AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME “ASISTENT LEKTOR” NË FAKULTETIN E
SHKENCAVE TË LËVIZJES PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS,
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në Udhëzimin e MASR me nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.46, datë 22.09.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik për tre njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026”, si dhe në shkresën e Dekanit të FSHL me nr.12/1 prot., datë 06.01.2026, “Kërkesë për rekrutimin e 2 (dy) “Asistent Lektor” me kohë të pjesshme në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit në FSHL, për vitin akademik 2025-2026”, Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në Web-in [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes si më poshtë :

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE SHËNDETIT

2(dy) Asistent Lektor

Moduli : “**Fitnes**”, (Bachelor).

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për “Asistent Lektor” në Modulin : “**Fitnes**”, janë si më poshtë:

I. I. KRITERE TE PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
2	Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
3	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
4	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
5	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
6	Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8. Nëse njëri nga kandidatët ka mbaruar specilizime afatgjata do të ekuivalentohet nota mestare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specilizime afatgjata.
7	Të ketë notë mesatare mbi 8-të në studimet e nivelit “Bachelor”, DIND, Master Shkencor dhe Specializime afatgjata, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8. Per çdo 0.1 note më shumë se 8.00, shtohet me 0.5 pike në vlerësim, gjithsej 10 pike
8	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

II. Kriteria specifike:

1. Kandidatët të kenë diplomë në fushën e Shkencave Sportive, Aktivitet Fizik dhe Shëndetit.
2. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit që kanë lidhje me fushën e studimit të kërkuar.
3. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së studimit.

III. Kriteria preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë përvojë akademike në fushën përkatëse.
2. Preferohen kandidatë që kanë bashkëpunuar më parë me UST.
3. Preferohen student të ciklit të tretë të studimeve “Doktorantë” në Shkenca Sportive në FSHL.

IV. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto

dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

V. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

VI. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.

VII. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.

VIII. Deri në datën 14.01.2026, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 16.01.2026 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.

IX. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.

X. Dekanati i FSHL-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 21.01.2026, për miratim në Rektorat.

- XI. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Administratori, Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHL, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *Web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

